Latest update: 26/07/20 01:00

Charity 1067406

KORONAVIRUSIN

Reference: www.doctorsoftheworld.org.uk/coronavirus-information/

COVID-19 INFOGRAPHICS

Çfarë është koronavirusi (COVID-19)?

COVID-19 është një sëmundje e re që mund të prekë mushkëritë, rrugët e frymëmarrjes dhe organet e tjera

Ajo shkaktohet nga një virus i quajtur koronavirus.

Simptomat

- Temperaturë të lartë (>38°C)
- Kollë të vazhdueshme të shfaqur rishtazi
- Humbje ose ndryshim të shqisës normale të shijes ose nuhatjes

Çfarë duhet të bëni nëse keni simptoma?

JU DUHET TË NDIQNI SA MË SHPEJT TË JETË E MUNDUR KËTO HAPA:

1. VETIZOLOHUNI

Qëndroni në shtëpi për të paktën **10 DITË**

Çdo person tjetër i familjes suaj ose që ka pasur kontakt të afërt me ju duhet të vetizolohet për **10 DITË**

2. TESTOHUNI PËR KORONAVIRUSIN brenda pesë ditëve të para nga shfaqja e simptomave

Mund t'jua kryejnë testin në banesë

Ose mund të paraqiteni në një vend testimi

TESTOHUNI PËR KORONAVIRUSIN

Për të rezervuar një test ose për ta porositur atë përmes internetit, vizitoni adresën www.nhs.uk/ask-for-a-coronavirus-test

Nëse nuk keni akses në internet, telefononi numrin 119 (ose numrin 0800 028 2816 në Skoci).

Nëse rezultati i testit është...

POZITIV:

- Ju duhet të përfundoni pjesën e mbetur të vetizolimit dhjetëditor
- Shërbimi i gjurmimit në zonën tuaj do t'ju kontaktojë për t'ju kërkuar ndihmë për ndalimin e përhapjes së mëtejshme të virusit

NEGATIV:

- Ju mund të dilni nga vetizolimi nëse ndiheni mirë dhe nuk keni më simptoma
- Mund të dalin nga vetizolimi edhe anëtarët e tjerë të familjes suaj ose që kanë kontakt të afërt me ju